

LIGJ
Nr.10 149, datë 28.9.2009

**PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.10 033, DATË 11.12.2008 “PËR
LOJËRAT E FATIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 12, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shoqëritë e miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhin në llogarinë e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit 0,5 për qind të xhiros vjetore, por jo më pak se:

- a) 2 000 000 (dy milionë) lekë në vit për shoqëritë e licencuara për kazino dhe lotari kombëtare;
- b) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë kazino elektronike;
- c) 1 000 000 (një milion) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë baste sportive dhe baste për gara në pistë;
- ç) 300 000 (treqind mijë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë bingo tradicionale e televizione.”.

Neni 2

Në nenin 44 bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 5.3, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

- “a) për rrethet e kategorisë së parë, 400 000 (katërqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;
- b) për rrethet e kategorisë së dytë, 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;
- c) për rrethet e kategorisë së tretë, 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 40 000 (dyzet mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;
- ç) për çdo makinë elektronike me më shumë se një pozicion (ruletë) organizatori paguan një kuotë fikse mujore prej 1 000 000 (një milion) lekësh dhe 300 000 lekësh në muaj për çdo pozicion loje, pavarësisht nga rrethi ku ushtron veprimtarinë.”.

Neni 3

Në nenin 45 pika 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

- “a) për tryezat me më shumë se një pozicion (ruletë), një taksë mujore në masën 300 000 (treqind mijë) lekë në muaj për çdo pozicion;

b) për çdo tryezë të lojërave (me letra ose/dhe me zare), një taksë mujore në masën 1 500 000 (një milionë e pesëqind mijë) lekë;

c) për lojërat elektronike dhe makinat slot, me fitim në çast dhe për videolotarinë, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore në masën 120 000 (njëqind e njëzetë mijë) lekë, për çdo kompjuter elektronik”.

Neni 4

Në nenin 51, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) konfiskimin e mjeteve të lojërave, magazinimin, si dhe shkatërrimin e tyre;”

Neni 5

Në nenin 61 “Dispozita kalimtare”, në fund të pikës 2 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Organi tatimor kryen rimbursimin e shumave të dëmshpërblimit për subjektet, të cilave u është revokuar me ligj licenca për kategoritë e lojërave “lotari çasti” dhe “lotari me shorte”.

Kriteret, mënyra, masa dhe forma e dëmshpërblimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6284, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**